



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NR. AKTI 1
14.02.2019

NR. VENDIMI 2
20.01.2020

VENDIM
“Për shpalljen e moskompetencës lëndore”

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë Për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e përbërë prej:

Kryesues: Sandër SIMONI

asistuar nga sekretare gjyqësore Evloinda ADILI, në Tiranë, sot më dt.20.01.2020, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në prani të Prokurorit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Dritan PRENÇI, mbrojtësit Nevzat TARELLI, kërkesën penale me nr.regj.themeltar 01/03, datë regjistrimi 14.02.2019 që i përket:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

KUNDËR: N.SH, A.SH, A.SH, K.SH, V.SH, B.SH, K.SH.

OBJEKTI: Konfiskim pasurie.

BAZA LIGJORE: Ligji nr.10192 datë 03.12.2009 ‘ *Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*’, i ndryshuar me ligjin nr.70/2017.

Gjykata, pasi mori në shqyrtim kompetencën e saj për gjykimin e kësaj çështje, mbi kërkesën dhe të prokurorit pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar,

V Ë R E N:

Se me vendimin nr.286 datë 18.12.2019 për fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është vendosur fillimi i funksionimit të Gjykatave

në datë 19.12.2019. Në të njëjtën datë me vendimin nr.304 gjyqtari i çështjes është caktuar si gjyqtar pranë Gjykatës së Posacme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Sipas vendimit njuhësues nr.13 datë 04.04.2018 të Gjykatës së Lartë çështjet penale të tjera të cilat nuk përfshihen në nenin 75/a të pandryshuar të K.Pr.Penale dhe ato të përfshira në nenin 135 pika 2 të Kushtetutës , nenin 8,9 të ligjit 95/2016 dhe nenit 75 /a të ndryshuar të K. Pr.Penale , janë në kompetencën lëndore të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore.

Sipas nenit 7 të ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar . trafikimit , korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese, përcaktohet se : “ *Kërkesat për marrjen e masave parandaluese shqyrtohen në shkallë të parë nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore ose nga Gjykata e Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar në bazë të kompetencës lëndore për veprat penale të kryera nga neni 75/a të K.Pr.Penale*”.

Procedimi pasuror ka nisur pasi, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec ka rregjistruar procedimin penal nr.443/2017 për veprën penale të “*Pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale*”, neni 237 i K.Penal. Kjo sipas urdhërit për rregjistrimin e procedimit penal 24.11.2017 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Me vendimin nr.170 datë 11.12.2017 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka vendosur dhe sekuestro preventive mbi llogaritë bankare të këtyre shtetasve.

Nuk ka asnjë akt tjetër apo vendim gjyqësor që lidhet me vepra penale të tjera përveç asaj të “*Pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale*”, neni 237 i K.Penal.

Duke konstatuar se vepra penale e “*Pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale*”, sipas nenit 75/a të K.Pr.Penale nuk është në kompetencë të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Si dhe duke pasur parasysh nenin 38 të ligjit ku dispozita kalimtare shprehet :

“ *Me krijimin e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjet e gjykuara për marrjen e masave parandaluese kundër pasurisë transferohen në këtë gjykatë dhe në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm sipas kompetencave lëndore për veprën penale të kryer , në bazë të nenit 75/a të K.Pr.Penale*”.

Neni 74 i këtij K.Pr.Penale i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017 parashikon:

“ *Gjykata e Rrethit Gjyqësor është kompetente për gjykimin e veprave penale, përveç atyre që i përkasin kompetencës së Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar* “.

Ndërsa neni 75/a parashikon veprat penale të cilat për shkak të akuzave, ose për shkak të subjekteve gjykohen nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar:

a) *krimet e parashikuara nga nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e;*

b) *çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale,*

organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal;
c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj;

Kompetenca lëndore e Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar gjen rregullim dhe në nenet 8 dhe 9 të ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, ku neni 8 parashikon kompetencën lëndore parësore, të rregulluar në nenin 75/a të K.Pr.Penale, në lidhje me nenin 135/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Ligji nr.35/2017, në dispozitën tranzitore, nenin 285, pika 1 ka parashikuar:

“ Deri në krijimin e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, çështjet penale në kompetencën lëndore të saj, sipas nenit 75/a të Kodit të ndryshuar me këtë ligj, do të gjykohen përkatësisht nga Gjykata për Krime të Rënda dhe Gjykatat e Rretheve Gjyqësore “.

Në vendimin njëhësues nr.13/2018, Kolegji Penal i Gjykatës së lartë ka arsyetuar:

“.....Të gjitha çështjet penale, që do të ndodhen për gjykim në gjykatat e krimeve të rënda, të cilat nuk janë në kompetencën lëndore të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, ditën e krijimit të kësaj të fundit, nëse nuk ka ligj që rregullon ndryshe, do të kalojnë për kompetencë lëndore sipas shkallës së gjykimit në gjykatat e zakonshme.

Çështjet penale të tjera, të cilat nuk përfshihen në nenin 75/a të pandryshuar të Kodit të Procedurës Penale edhe ato të përfshira në nenin 135 pika 2 të Kushtetutës, nenin 8 dhe 9 të Ligjit nr.95/2016 dhe nenin 75/a të ndryshuar të Kodit të Procedurës Penale, janë në kompetencën lëndore të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe apeleve me juridiksion të përgjithshëm penal, deri në datën e krijimit të gjykatave të posaçme. Pas krijimit të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, çështjet në gjykim para gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, do të përfundohen nga këto të fundit”.

Kjo praktikë e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në referim të nenit 438 pika 4 të K.Pr.Penale është e detyrueshme për gjykatat në gjykimin e çështjeve të ngjashme dhe ky detyrim lidhet si me gjyqtarin e hetimit, gjyqtarin e seancës paraprake dhe gjykatën që gjykon themelin e çështjes.

Kjo dispozitë procedurale është në frymën e nenit 141 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ndryshuar me ligjin nr.76/2017, ku parashikohet se Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit.

Më datë 19.12.2019 ka filluar funksionimin Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin

e Organizuar, dhe Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda është emërtuar Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Për këtë është marrë vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor datë 19.12.2019, në mbështetje me nenet 135 pikat, 1 dhe 2, 147, pika 1, neni 147/a shkronja “ë”, neni 179 pika 8 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 62 i ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 11, neni 15 pika 4, shkronjat “c” dhe ç”, nenin 22 dhe nenin 83 të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, nenin 57 të ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Po më datë 19.12.2019 është krijuar Prokuroria e Posaçme, duke pushuar së funksionuari Prokuroria për Krime të Rënda.

Në këtë mënyrë, kjo gjykatë (Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar) duhet të konstatojë e të shpallë moskompetencën lëndore për gjykimin e kërkësës me objekt konfiskim pasurie. Kjo pasi vepra penale e “*Pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale*”, sipas nenit 75/a të K.Pr.Penale nuk është në kompetencë të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në këtë rast, gjykata kompetente përcaktohet nga dispozitat e përgjithshme që rregullojnë kompetencën lëndore dhe tokësore të gjykatave të zakonshme, pasi vepra penale e “*Pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale*”, nuk është në kompetencë të Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Sipas nenit 76, 77 të KPrP, dhe dekretit të Presidentit të Republikës nr.6201, datë 8.6.2009 “Për caktimin e kompetencave tokësore të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë së secilës prej tyre”, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec është kompetente për gjykimin e kësaj kërkesë, pasi procedimi pasuror ka nisur pasi Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec ka rregjistruar procedimin penal nr.443/2017 për veprën penale të “*Pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale*”, neni 237 i K.Penal. Kjo sipas urdhërit për rregjistrimin e procedimit penal 24.11.2017 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Meqë procedimi penal është në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe kërkesa për konfiskim duhet të kalojë për kompetencë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Si konkluzion, referuar neneve 75/a të K.Pr.Penale, nenin 285 të ligjit 35/2017 “Për disa ndryshime në K.Pr.P, nenin 7 dhe 38 të ligjit 10192 datë 03.12.2009 ‘*Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”, i ndryshuar me ligjin nr.70/2017, kjo kërkesë duhet ti kalojë për kompetencë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, bazuar në nenin 75/a të K.Pr.Penale, nenin 285 të ligjit 35/2017 ‘’Për disa ndryshime në K.Pr.P, nenin 7 dhe 38 të ligjit 10192 datë 03.12.2009 ‘*’Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë’’*, i ndryshuar me ligjin nr.70/2017.

VENDOSI:

1. Shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për gjykimin e kërkesës penale me numër 01/03 Akti datë 14.02.2019 me objekt : Konfiskim pasurie ndaj shtetasve N.SH, A.SH, A.SH, K.SH, V.SH, B.SH, K.SH.
2. Dërgimin e çështjes gjykatës kompetente, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.
3. Urdhërohet sekretaria të përcjellë dosjen administrativisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec

U shpall në Tiranë, më dt. 20.01.2020.

SEKRETARE

Evloinda ADILI

GJYQTAR

Sandër SIMONI

